



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Procesverbal

nga takimi publik me qytetarë i mbajtur më 26 Dhjetor 2023

Takimi filloi në orën 14:00

Takimin publik e hapi dhe e kryesoi z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës.
Në takim ishin të pranishëm një numër i qytetarëve (25 pjesëmarrës);
Drejtorët e Drejtorive të Administratës së Komunës, përfaqësues të OJQ-ve dhe mediat.

Tema:

Realizimi i projekteve dhe aktiviteteve tjera të parapara për vitin 2023

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, qytetarë të nderuar ju përshëndes të gjithëve dhe ju falënderoj që keni ndarë kohën që bashkërisht të bëjmë shpalosjen e punës gjatë këtij viti. Jemi duke bërë përpjeke që të jemi sa më transparent me juve, që të shohim ecurinë e punëve dhe cilat janë të arriturat që kemi planifikuar ti realizojmë në këtë vit. Tashmë jemi në fund apo përmbyllje të këtij viti kalendarik dhe besoj që administrata e ka bërë punën e vet që të ju njoftojë maksimalisht, që të jeni numër sa më i madh ku edhe unë do të isha më i kënaqur sepse do të kishim pasur mundësi për të bashkëbiseduar për punët dhe projektet por sidoqoftë juve që jeni këtu prezent ju falënderoj të gjithëve dhe po bëjë përpjeke që në pika të shkurta të ju jap disa prej projekteve më të rëndësishme të cilat janë realizuar në vitin 2023. Ajo që vlen të cekët është fakt dhe një informacion i mirë të cilën sapo e mora nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave ku deri në këto momente kemi shfrytëzuar 92% të buxhetit për këtë vit dhe kjo është jashtëzakonisht një punë e kënaqshme e ekzekutivit sepse e dimë që fatkeqësisht shumicën e viteve kalendarike këto tre muajt e fundit janë me ngarkesën më të madhe në kuptimin e realizimit të pagesave dhe fakti që ne po e kalojmë 92% pra është diçka e mirë dhe tregon për një rezultat pozitiv të kësaj qeverisjeje. Po bëjë përpjeke në pika të shkurta të ju pasqyrojë punën dhe mbas dy muaj sigurisht që do ta paraqes edhe raportin financiar së bashku me projektet para asamblistëve komunal. Takimi i ditës së sotme është ekskluzivisht për ju, në mënyrë që të keni informacionet rreth punëve dhe aktiviteteve të cilat i kemi pasur në vitin 2023, po e fillojmë me:

Drejtoria e Administratës, në vitin 2023 janë lëshuar gjithsej 92,328 dokumente të ndryshme për qytetarët që nënkupton që po i ofrohemi shifrës së 100,000, që është një volum i madh i punëve që janë kryer në këtë vit.

Jemi në përmbyllje të projektit të rregullimit të hapësirës së oborrit të objektit të Komunës së Podujevës, kemi avancuar në shërbimet në sistemin digjital për nxjerrën e dokumenteve digjitale në E-kioska dhe tash ato janë funksionale dhe qytetarët shumë prej këtyre shërbimeve mund ti marrin drejtpërdrejt pa pasur nevojë të vijnë në Komunë.

Kemi filluar procesin e zgjedhës së këshillave të fshatrave dhe deri në pushimet e verës ka ecur procesi, në pesë ose gjashtë lokalitete kemi provuar disa ka pasur suksese në disa nuk ka pasur për shkak të pjesëmarrjes jo të mirë dhe mbetet që në vitin 2024 të vazhdojmë me këtë proces që të mundemi të realizojmë zgjedhjen e këshillave të fshatrave.

Drejtoria e Buxhetit dhe Financave

Është planifikuar dhe aprovuar buxheti për vitin 2024, buxheti me i larti në historinë e Komunës së Podujevës në vlerë prej 31,043,019.00 euro.

Gjatë viti 2023 janë regjistruar afër 1500 objekte të reja në sistemin e tatimit në pronë dhe këto tash do të na mundësojnë që faktikisht të kemi një rritje të këtij procesi në kuptimin e të hyrave vetanake për kundër faktit që ne e kemi marr një vendim në seancën e parafundit që qytetarëve tanë të u lehtësojmë tatimin në pronë në vlerën deri 100 euro, të lirohen të gjithë qytetarët që e kanë deri në këtë vlerë dhe besojë ajo do ta ketë një efekt negativ në kuptimin e grumbullimit të hyrave vetanake për vitin 2024. Por regjistrimi i 1500 objekte të reja të banimit në tatim në pronë sigurisht që do të ndikojë pozitivisht dhe të kompensoj shumën e prej 100 euro që i kemi liruar qytetarët për vitin 2024.

Nga të hyrat vetanake të planifikuara të Komunës së Podujevës në vitin 2023 janë realizuar afër 2.2 milion euro dhe është një shumë që është tejkaluar në vlerë prej 400,000 euro, indikator ky që tregon se është bërë një punë e mirë në realizimin e të hyrave vetanake, sigurisht që këto mjete do të na shërbejnë për vitin 2024 në drejtim të realizimit të projekteve të reja për qytetarët e Komunës së Podujevës.

Drejtoria e Arsimit

Drejtoria e arsimit ka pasur një varg punësh dhe projektesh të cilat i ka realizuar gjatë këtij viti, po i numëroj disa prej tyre që të mos ju ngarkoj juve shumë sepse materialin e keni të shkruar në ekran.

Furnizimi me kabinete muzikore projekt i cili ka kushtuar afër 8,730.00 euro. Në bashkëfinancim me IOM në fushën e edukimit fillor janë pajisur me kabinete me shkenca ekzakte dhe kabinete muzikore në shkollat e fshatit Orllan dhe Sfeqël.

Furnizimi me kabinete të gjeografisë, historisë, matematikës, kontratë e nënshkruar në vlerë prej 48,681 euro.

Furnizimi me rekuizita sportive, kontrata e nënshkruar në vlerë prej 15,279 euro. Furnizimi me inventar për shkolla, dollap personal për nxënës dhe inventar në vlerë prej 140,000.00 euro.

Janë hapur dy çerdhe të reja njëra në fshatin Lluzhan dhe tjetra në fshatin Sfeqël.

Ka filluar ndërtimi edhe i dy çerdheve të reja, njëra në qytet dhe njëra në fshatin Batllavë të dyja këto çerdhe janë financuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë. Furnizimi me inventar për çerdhe të reja dhe këto ekzistuese është në vlerë afër 54,729.00 euro.

Kemi pranuar donacion të vlefshëm për nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Fan S Noli” me pajisje në zdrukthëtari në bashkëpunim me Komunën e Kestelit në bursa të Turqisë. Është bërë instalimi i kamerave të sigurisë në 9 objekte shkollore me qëllim të rritjes së sigurisë të nxënësve në ato shkolla.

Është inauguruar qendra e parë e karrierës në Podujevë. Kemi ndarë bursa për 265 student në vlerë afër 100,00.00 euro, pastaj është bërë inaugurimi i masave të efijencës së energjisë, projekt që është realizuar në bashkëpunim në mes Qeverisë së Kosovës dhe Bashkimit Evropian dhe Bankës Botërore në vlerë prej 730,000.00 euro.

Gjatë këtij viti janë kryer punimet në ndërtimin e objektit shkollor në fshatin Obrancë ku tash është objekti i gatshëm është duke pritur të punohet edhe në ambientin e jashtëm të kësaj shkolle dhe shpresojmë që me fillimin e gjysmën vjetorit të dytë nxënësit do të futën në objektin e ri shkollor.

Janë duke u kryer punët në fazën finale në fshatin Dumosh në rregullimin e objektit të ri shkollor dhe dy sallave sportive ku njëra është në shkollën “ Enver Maloku” dhe tjetra në shkollën fillore të mesme të ulët “ Naim Frashëri” në Podujevë.

Është intervenuar në dhjetëra shkolla për renovimin dhe rregullimin e infrastrukturës shkollore.

Ndërtimi i ashensorit, pjerrinave dhe renovimi i tualeteve për nxënësit me nevoja të veçanta në SHFMU "Shaban Shala" në Podujevë të financuar nga Bashkimi Evropian që kap vlerën 150,000 euro, njëkohësisht janë duke u zhvilluar punimet në ndërtimin e SHFMU " Ilir Konushëfci "Lugë, që është po ashtu një projekt që financohet nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Renovimi i tërësishëm i brendshëm i pjesës së vjetër të objektit të shkollës "Shaban Shala" në Podujevë të financuar nga Bashkimi Evropian që kap vlerën 350,000 euro.

Realizimi i projektit "Yeni" bashkëfinancim mes Komunës së Podujevës dhe Caritasit Zviceran për dy shkollat e mesme "Aleksander Xhuvani" dhe "Fan S. Noli" në Podujevë që kap vlerën 9,000 euro.

Furnizim me inventar për pesë klasat përgatitore në pesë shkolla në bashkëfinancim me Caritasin Zviceran.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

Drejtoria e Shëndetësisë ka realizuar po ashtu një varg punësh dhe projektesh gjatë këtij viti kalendarik.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka ofruar 214,743 shërbime për qytetarë.

Në Qendrat e Mjekësisë Familjare në teren janë ofruar 48.613 shërbime për qytetarë.

Nga shërbimi mobil shëndetësor janë ofruar 7,763 shërbime shëndetësore në shtëpi për pacientët në nevojë.

Urgjenca e Qytetit po ndërtohet në bashkëpunim me organizatën nga Katari dhe është në fazën finale të punimeve, presim që në pranverën e vitit të ardhshëm të përfundojë si projekt. Sivjet janë rinovuar disa objekte shëndetësore, duke përmirësuar infrastrukturën e përgjithshme të këtyre objekteve.

Qendrat e Mjekësisë Familjare janë furnizuar me pajisje të reja mjekësore. QKMF është furnizuar me 4 autoambulanca të reja.

Ka përfunduar projekti i ndërtimit të 22 shtëpive, tashmë familjet janë strehuar në lagjen e re, financim që është bërë nga shoqata " Shqiptarët për Shqiptarët".

Janë subvencionuar në vlerë të 200 mijë euro shumë qytetarë për blerjen e barnave, si dhe kemi ndihmuar shumë qytetarë me sëmundje të rënda kronike.

Është nënshkruar marrëveshja me Shoqatën "Jetimat e Ballkanit" për ndërtimin e Qendrës rezidenciale për persona të moshuar në vlerë prej 2.5 milionë euro, projekt në të cilin me 500 mijë euro participojmë ne si komunë ndërsa pjesën tjetër do ta financojë Shoqata " Jetimat e Ballkanit".

Janë hapur në bashkëpunim me organizatën nga Katari rreth 100 puse për familje me gjendje jo të mirë sociale.

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Ka realizuar po ashtu një varg punësh dhe projektesh që lidhen me fushën e saj.

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Batllavë, Gërdoc, Kaçibeg në gjatësi 1.548 m.

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dumnicë në gjatësi 925 m.

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Sylevicë, Tërnavicë në gjatësi 1.850 m.

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Bellopojë projekt 2 vjeçar, në gjatësi 2.743 m.

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat: Godishnjak, Lluzhan dhe Shakovicë në gjatësi prej 1.444 m.

Asfaltimi i rrugëve Tërnav, Halabak në gjatësi 1.231 m

Asfaltimi i rrugëve Gllamnik dhe Siboc në gjatësi 1.521 m

Asfaltimi i rrugëve Lladoc dhe Shajkoc në gjatësi 1.102 m

Asfaltimi i rrugëve Orllan me rrethinë në gjatësi 2.885 m

Asfaltimi i rrugëve të qytetit i ndarë në tri Loto, Loto I - 225 m, Loto II- 1.181 m , Loto III – 952 m.

Asfaltimi i rrugëve Letanc, Peran dhe Llapashticë në gjatësi 2.515 m

Asfaltimi i rrugëve Lupç, Majac në gjatësi 2.174 m

Asfaltimi i disa rrugëve në fshatrat: Pakashticë, Zakut, Kërpimëh dhe Metehi në gjatësi 1.837m.

Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës “ Xhemajl Mustafa” ka filluar dhe është në gjatësi 2.733 m. Pra nëse e shohim në total janë 26.886 km rrugë të asfaltuara në Podujevë gjatë këtij viti.

Po ashtu i kemi edhe disa projekte dyvjeçare të cilat janë përmbyllur në këtë vite, ku ndër to janë:

Asfaltimi i rrugës “ Skenderbeu” është përfunduar.

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Gllamnik kanë përfunduar.

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Llapashticë kanë përfunduar.

Asfaltimi i rrugëve në qytet po ashtu janë të përfunduara.

Asfaltimi i rrugëve lidhëse në fshatrat: Llaushë, Doberdol, Buricë, Konushec, Dumosh dhe Sfeqël kanë përfunduar.

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Revuq- Bajqinë, të përfunduara.

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Llugë- Konushec, të përfunduara.

Asfaltimi i rrugëve në fshatrat Bradash-Dobratin, të përfunduara.

Asfaltimi i rrugëve në fshatin Letanc, të përfunduara.

Po ashtu gjatë këtij viti kemi pasur disa memorandume bashkëpunimi me Ministrin e Mjedisit Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës.

Sanimi dhe rehabilitimin e rrugës së dëmtuar nga vërshimet në fshatin Pakashticë në vlerë prej 154,000.00 euro.

Zgjerimi, sanimi dhe riasfaltimi i rrugës kryesore në fshatin Shamalluk në vlerë prej

186,500.00 euro, projekt i cili po shpresojmë që në këto ditë të përmbyllet i tëri.

Ndërtimi i rrugës Turuçicë – Herticë në vlerë prej 350,000.00 euro, projekt i cili është në proces së lidhjes së kontratës.

Këtë vit është bërë një punë e madhe që ka të bëjë me shpronësimin për rregullimin apo zgjatjen e rrugës “ Vëllëzrit Frashëri” nga ura te stacioni që vazhdon deri te Agnesa , është një projekt ku Komunës së Podujevës vetëm shpronësimi i ka kushtuar afër 1,000,000.00, ku tashmë procesi i shpronësimit është kryer ndërsa vitin e ardhshëm fillojmë me realizimin e projektit, zgjatjen e asaj rruge dhe lidhjen me magjistralen Prishtinë-Podujevë.

Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë

Në sektorin për Kadastër dhe Gjeodezi janë pranuar 11290 kërkesa apo 96,6% e kërkesave janë trajtuar dhe aprovuar.

Në sektorin e Pronës për periudhën Janar-Dhjetor janë shqyrtuar 399 kërkesa, ku janë trajtuar dhe kanë marrë përgjigjen meritore.

Kanë përfunduar procedurat e bartjes së pronave për Zonat Kadastrale Obrancë, Surkish dhe Livadicë, prona të cilat janë kthyer në pronësi të komunës, pra është një projekt i cili është realizuar kjo në zonën kadastrale të fshatit Obrancë është për varrezat e reja të qytetit të Podujevës në sipërfaqe afërsisht rreth 10 hektar, në zonën kadastrale të fshatit Surkish është planifikuar për ndërtimin e spitalit të qytetit të Podujevës projekt të cilin kemi ardhur shumë me vullnet të madh që do ta bëjmë por sipas të gjitha gjasave pas diskutimeve të gjata që kemi pasur me Ministrin e Shëndetësisë si projekt nuk besoj që do të realizojmë për faktin e problemit të kapaciteteve humane, prandaj jemi në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë që të fillojmë me kontrole specialistike për qytetarët e komunës së Podujevës, ku veçse e kemi ofruar në dispozicion objektin që është në afërsi të shkollës “ Enver Maloku” për Ministrin e Shëndetësisë dhe Qendrën Klinike Universitare dhe jemi në diskutim që së shpejti të fillojmë me këto shërbime, në një formë të kemi një mini klinikë por jo në kuptimin e plotë të spitalit për shkak të kapaciteteve dhe mungesës së kapaciteteve humane. Ndërsa sa i përket zonës në Livadicë, pronat janë ndarë për parkun industrial për afërsisht 37 hektar dhe besojmë që së shpejti në vitin e ardhshëm kemi për të filluar me realizimin e infrastrukturës për këtë projekt të rëndësishëm për qytetarët tanë.

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit

Investimet kapitale: është restauruar shkolla e vjetër e fshatit Sfeqël në kuadër të investimeve në trashëgimi kulturore dhe është funksionalizuar si çerdhe.

Ka filluar ndërtimi i Qendrës Multifunktionale, projekt në bashkëfinansim me Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe pritet që në vjeshtën e viti 2024 të përmbyllet si projekt.

Është ndërtuar dhe vendosur në shesh shtatorja e “Adem Demaçit”.

Është nënshkruar kontrata për ndërtimin e fushave sportive në vlerë 425,000 euro dhe janë duke u realizuar si projekte.

Është hapur Biblioteka e Qytetit në hapësirat e objektit të vjetër të Komunës, është bartur në hapësirën e re.

Subvencione:

Bazuar në thirrjet publike për financim të OJQ-ve në Kulturë, Rini dhe Sport, në thirrjet për projektet individuale, përmes vendimeve të Kryetarit dhe vendimit të Kuvendit Komunal, DKRS ka subvencionuar klubet sportive afërsisht në shumë prej 150,000 euro.

Kultura:

Galeria e Arteve – 12 ekspozita për 12 muaj

Manifestime – 15 manifestime të ndryshme kulturore

Ditët e Diasporës – si asnjëherë tjetër, për tre javë, çdo ditë ka pasur aktivitete të ndryshme kulturore dhe sportive në sheshin e qytetit

Teatri – 3 premiera për skenën e mbrëmjes, 2 premiera për fëmijë, 30 repriza të shfaqjeve dhe 9 shfaqje mysafire. Kurse Teatri Avdush Hasani ka përfaqësuar Podujevën duke dhënë 7 shfaqje si mysafirë.

Kinemaja–memorandumi me Qendrën Kinematografike të Kosovës dhe transmetimi i 8 filmave prodhim vendor, në ambient të hapur.

Botime librash – 20 libra të rinj, janë botuar vetëm në vitin 2023 me përkrahjen financiare të Drejtorisë.

Biblioteka - Libra të rinj– 760 tituj të rinj i janë shtuar bibliotekës së qytetit, në gjithsej 4921 kopje. Në Bibliotekë gjatë vitit janë regjistruar gjithsej 445 lexues, kurse janë huazuar 4012 libra. Salla e leximit është shfrytëzuar nga 4425 lexues, kurse salla e fëmijëve nga gjithsej 700 nxënës.

Panaire – Është organizuar Panairi i librës dhe 2 panire me produkte artizanale.

Grupe të margjinalizuara – Janë përkrahur projekte dhe organizuar aktivitete në mbështetje të komunitetit ashkali, në kulturë dhe sport.

Rinia:

Aktivitete Rinore–Përpos subvencionimit të OJQ-ve me subvencione në projekte për të rinjtë, gjithashtu janë organizuar gjithsej 9 aktivitete që kanë synuar gjithë përfshirjen e të rinjve të cilat kanë pasur kryesisht karakter edukues.

Sport:

Organizime sportive - 31 organizime sportive, si turne në futboll, gara na Basketboll, Volejbol, Bjeshkatari, Kamping, Not, Çiklizëm, Arte të Miksuara Marciale, Karate, Tenis, Ping Pong, Shah dhe të tjera me theks përfshirjen e vajzave në sport dhe përgjithësisht të rinjve.

Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtim - ka kryer një varg punësh dhe aktiviteteve si që janë:

Mirëmbajtja dhe pastrimi i lumenjve (është pastruar një pjesë e lumit Kaqanolli dhe Prrocka në fshatin Bradash).

Mirëmbajtja e ndriçimit publik- në dy kontrata deri me tani janë ndërruar diku 3230 trupa ndriçues.

Mirëmbajtja dhe furnizimi me kamera-janë vendosur 9 kamera të reja të sigurisë, janë rinovuar 29 kamera, janë vendosur afër 7000m kabëll me fibra optike.

Furnizimi me drunj dekorativ dhe lule, ku janë mbjellë në periudhën sezonale në hapësirat publike.

Dekoromi i qytetit për festat e fund vitit.

Trajtimi i qenve endacak - (Duke u bazuar në raportin e komisionit janë trajtuar gjithsej 159 Qen Endacak).

Ndërtimi i Stacionit të Autobusëve – ka përfunduar mbi 50% e projektit, vitin tjetër finalizohet tërësisht si projekt.

Mirëmbajtja e infrastrukturës publike(kanalizim fekale dhe atmosferike është intervenuar në 170 vende: de bllokim me cisternë, pastrin pesetave, shkarkim me cisterne, ndërrim i gypit, montim i kapakëve ndërtimi dhe rindërtimi.

Largimi i deponive ilegale(janë larguar 62 deponi ilegale).

Ndërtimi i trotuareve në qytet(janë ndërtuar 4882m trotuar) është rregulluar trotuari, shtegu i biçikletave është në përfundim dhe është riparuar në tërësi rr. „Hakif Zejnullahu.”

Zgjerimi dhe rregullimi i shtratit të lumenjve - është rregulluar lumi Llap në qytet në gjatësi 650m).

Shenjëzimet horizontale dhe vertikal –janë ndërtuar 8583m vija të bardha,39shenja në rrugë, 353m² vendkalime, 388m² ngjyra e kuqe në vendkalime, shtigje të biçikletave 651m². Ndriçimi publik në qytet- është ndërtuar 28 km gjatësi me 552 trupa ndriçues.

Ndërtimi i rrjetit të kanalizimeve fekale dhe atmosferike është bërë ndërtimi i kolektorëve: Letanc 515m, Bradash1155m dhe Shajkoc- Batllavë 2214m.

Meremetimi i rrugëve me zhavorr janë rregulluar 63 rrugë në gjatësi 24km 725m.

Ndërtimi i urave dhe kalesave - janë ndërtuar 7 ura: Pollatë, Dvorishtë, Lepajë, 3x Majac dhe ura në Bajqinë.

Ndërtimi i rrugëve me elemente betoni në qytet dhe fshatra janë 2645m rrugë me kubëza.

Ndërtimi i mureve mbrojtëse: Muri mbrojtës Pakashticë, Llapashticë, Majac,rr.,Hakif Zejnullahu”.

Riparim i rrugëve të asfaltuara(8615 m² rrugë të riparuar).

Shqyrtimi i kërkesave për shfrytëzim të hapësirave publike janë shqyrtuar 50 lëndë të ndryshme.

Intervenimet e zjarrfikësve është intervenuar në 695 raste.

Drejtoria e Inspeksionit

Janë bërë inspektime në fusha të ndryshme nga të gjitha fushat.

Inspektorët e tregut kanë bërë kontrole të rregullta në terren, kanë shqiptuar 11 gjoba mandatore ndaj subjekteve të ndryshme afariste.

Janë përcjellë 14 fletëparaqitje për në gjykatë për shkelësit për mosrespektim të orarit të punës. Vendime për asgjësim të mallit të prishur 20, duke pasur për qëllim ruajtjen e shëndetit të qytetarëve.

Inspektorët e shërbimeve komunale këtë vit kanë shqiptuar 18 gjoba mandatorë.

Inspektorët e komunikacionit kanë shqiptuar 38 gjoba mandatore për shkelësit e ligjit.

Inspektorët e Mjedisit kanë shqiptuar 15 gjoba mandatorë.

Inspektori i Ndërtimit ka trajtuar 52 objekte me leje, kurse ka shqyrtuar 43 objekte pa leje.

Këtë vit janë rrënuar 15 objekte të ndryshme pa leje.

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ka bërë subvencionimin me fidane të mjedrës në formën e pagesave direkt me nga 1000 euro për 37 fermerë përfitues.

Subvencionimi me fidane për feferona në formën e pagesave direkt me nga 500 euro për 13 zbatuesit e projektit.

Furnizimi dhe montimi i serrave 300m² për 45 përfitues të projektit.

Përkrahja e 75 fermerëve përfitues të projektit me moto kultivator.

Përkrahja e 130 blegtorëve me nga një mëshqerrë barrëse.

Projektet e realizuara në bashkëpunim me donatorët – janë si në vijim: Furnizimi me mekanizëm bujqësor 53 përfitues (14 moto kultivatorë me frezë dhe rimorkio, kurse 39 moto kultivatorë me kosë dhe rimorkio) projekt në bashkëpunim me organizatën e Katarit.

Përzgjedhja dhe montimi i serrave 176 m² për 10 fermerët përfitues, dhe shpërndarja e 4 pajisjeve laktofriz për fermerë. Projekt në bashkëpunim me IADK.

Mbjellja e 70 drunjëve dekorativ në bashkëpunim me FINCA Kosova.

Përkrahja e 50 fermerëve përfitues të projektit me Freza dheu, projekt me TIKA-n.

Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

Është hartuar dhe miratuar Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2023-2025.

Projekti “Subvencionimi i kapaciteteve prodhuese” – Qëllimi i këtij projekti ka qenë përkrahja për bizneset të cilat investojnë në blerjen e makinerive prodhuese. Janë mbështetur 16 biznese në vlerë mbi 62 mijë euro.

Projekti “Ndërtimi i shtigjeve të ecjes në fshatrat Shakovicë - Bellopojë dhe Pakashticë e Poshtme – Zakut” –vlera totale e projektit 248,876.34€.

Projekti “Mbështetja me bimë mjaltëdhënëse” - Në kuadër të këtij projekti janë furnizuar 5 përfitues me fidane të Sherbelës dhe farë të Facelias me qëllim të rritjes së prodhimtarisë së mjaltës, prej tyre tri femra dhe dy meshkuj.

Projekti PPP “Parkingun nëntokësor”-janë zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme dhe është bërë shpallja publike, si projekt nuk ka ecur fatkeqësisht, ku kemi pasur dy operator të cilët janë paraqitur në këtë projekt dhe duket që ky vite nuk ka qenë i suksesshëm në realizimin e këtij projekti për faktin që njëri prej operatorëve që ka shkuar deri në finale për tu përzgjedhur në fund ka ofruar një projekt i cili nuk është në përputhje me atë që ne e kemi kërkuar me projektin tonë prandaj kemi qenë të obliguar që të kthemi në pikën zero edhe njëherë me këtë projekt.

Projekti “Platforma elektronike dhe harta digjitale” - Është bërë përditësimi i katalogut dhe hartës digjitale – platformës online të parcelave komunale për dhënie në shfrytëzim.

Projekti i furnizimit me 100 mjete/pajisje pune për biznese start-up dhe ekzistuese. (Rrobaqepësi, Automekanikë, Hekrari etj), është në procedura të prokurimit publik (ankesa në OSHP).

Projekti “Zona Industriale” janë mbajtur dëgjime publike dhe takime në ministri relevante dhe janë siguruar shumica e pëlqimeve-lejeve për funksionalizimin e Zonës, është bërë shpronësimi i pronës/hapësirës ku do të ndërtohet Zona Industriale dhe jemi në finalizimin e të gjithë procesit.

Është themeluar Ndërmarrja publike “Eko Llapi” për të ofruar shërbime publike më të mira dhe me kosto më të ulët dhe tani është i hapur konkursi për anëtarë të bordit të drejtorëve të ndërmarrjes.

Nga sektori i regjistrimit të bizneseve janë trajtuar 823 lëndë.

Projekti “Mbështetje me serra 100m², Kultivator me frezë dhe Kultivator me kosë” - Projekti është realizuar në bashkëpunim me Islamic Relief Kosova ku janë mbështetur 50 fermerë me kultivator me frezë. Ndërsa, 23 fermerë tjerë janë mbështetur me kultivator me kosë. Mbështetja e fermerëve të cilët kanë aplikuar për serra vazhdon në fillim vitin e ardhshëm.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, këto janë disa prej projekte kryesore por ka edhe disa projekte të cilat janë harruar të cekën nga drejtorët, por besoj që janë të mjaftueshme për të pasur mundësi që të hapim debat me ju dhe të diskutojmë së bashku, si dhe ti dëgjojmë vërejtjet e juaja dhe sugjerimet por edhe ndonjë plotësim që kemi pasur mundësi të harrojmë ne dhe nuk e kemi përmendur këtu, prandaj pa humbur kohë të pranishëm në sallë me neve janë edhe drejtorët e drejtorive po thuajse të gjithë dhe jemi të hapur për debat dhe diskutime për çfarë do që juve ju intereson edhe pse jo kërkesat tjera. Ajo që mund të ju them këtu publikisht para juve por prej këtu po i ftoj qytetarët që nga fundi i muajit janar përkatësisht fillimi i muajit shkurt planifikoj që të dal në teren në fshatra dhe lokalitete që të bashkë bisedojë me qytetarë dhe të marr kërkesat konkrete të qytetarëve për

lokalitetet konkrete që duhet ti realizojmë për vitin 2024, dhe mbas takimeve që do ti realizojmë në tërë Llapin do të vije dhe do të bëjë të gjitha projeksionet e projekteve kryesore që do të shkojnë për vitin 2024 që do të realizohen në Komunën tonë. Sigurisht që nuk kemi me pas mundësi që të gjitha kërkesat ti realizojmë por do të bëjmë me prioritet se cilat janë më të larta që ti realizojmë në 2024 dhe të tjerat i vazhdojmë në 2025.

Të nderuar qytetarë fjala është e juaja.

Bahri Kastrati nga fshati Pakashticë e Epërme, ndër të tjera shtroi pyetje direkt Kryetarit, kur ke qenë në fshat ke thënë se do të jem kryetar për të gjithë qytetarët pa dallim partive dhe do të jetë dera hapur për të gjithë qytetarët që keni kërkesa, ankesa dhe sugjerime dhe do të jem i hapur. E pikërisht unë para një muaji kam qenë te zyra e juaj po fatkeqësisht ajo dera ishte e mbyllur dhe një zonjë nga ana e tjetër u hapke derën vetëm atyre personave që dëshiron, unë prapë kom tentuar të hyj edhe dy tri herë dhe në herën e katërt më është hapur dera dhe më pyeti se çka dëshironi, unë i thash se dua të bëjë një termin te kryetari për të biseduar rreth një rruge dhe duke iu prezantua i tregova që jam përfaqësues i lagjes. I tregova që kam qenë te drejtori Leutrim Krasniqi dhe nuk jemi të kënaqur me zhvillimin e punës që po bëhet aty në lagjen tonë, ndërsa ajo mu përgjigj se deri të hënën të thirr kryetari, por është bërë një muaj deri më sot dhe nuk jam thirrur. Unë kam qenë te drejtori dhe kam biseduar me inxhinierin e rrugës dhe me disa përfaqësues të komunës që ishin aty për asfalt, fjala është për rrugën Pakashticë e Epërme te Kastratët ku është shtruar një segment i rrugës 186 m. Rruga që është shtruar nga qeverisja lokale e mëparshme është 5 metra gjerësi, kurse ju jeni ardhur me një reduktim bukur të madh ku e keni bërë asfaltimin e rrugës me 3 metra pra me dokument me 12 gypa që kalon uji për to por fati jon që inxhinieri ka gabuar dhe i ka bërë 18 gypa dhe tjetër gjë është që unë e kam bërë matjen e asfaltit gjerësinë e saj, kur të matet nga lart e ki asfaltin 2.95 m dhe vetëm në kthesa e ki 3 metra rrugën kjo është një keq menaxhim sipas neve banorëve në letër shkruan se bankina 50 deri 70 cm dhe ka bankinë me 30 cm ndoshta edhe më pak, dhe ku janë 2 metra gjerësi dhe 186 metra gjatësi ku janë shuma e këtyre parave, mendoj që kam të drejtë të kërkoj këtë sqarim sepse jam qytetar i asaj pjese dhe besoj që kam të drejtë të di se ku po shkojnë taksat tona. Nuk e di inxhinieri i Komunës a del në teren për të parë se në çfarë gjendje është rruga, ku duhet të bëhet zgjerimi i rrugës, të shikoj gjatësinë dhe gjerësinë apo duhet të bashkëngjitet me rrugën që ka mbetur gjysmë. Ajo rrugë është në gjendje tepër të keqe, mund ta quash si shteg për biçikleta. Në fillim kanë qenë disa persona e kanë bërë shpimin e saj dhe kanë ikur shumë shpejt. Një kanal nuk është hapur dhe një reshje që vjen e vërshon të gjithë asfaltin. Tjetër, rruga është 20 metra e gjerë dhe mundesh me manipuluar shumë lehtë, por asfalt që ne e shfrytëzojmë janë vetëm 2.95 cm. Sipas meje komuna është duke punuar vetëm në favor të kompanive dhe jo në të mirë të qytetarëve. E dini vetë që keni qenë në lagje dhe e keni parë se ku kanë vendosur kubëza, ndërsa unë kam bërë kërkesën për 850 deri 900 metra që të asfaltohet, rrugë e cila na lidh me fshatin Pakashticë, ku sipas banorëve të asaj lagje është një projekt shumë i mirë. Në rast të rast të bllokimit të rrugës ne nuk kemi ka të shkojmë dhe e vetmja mënyrë nga Kërpimehi e të gjitha fshatrat e kanë atë segment. Nuk po bëhet investim sa duhet, mendoj që disa investime që i keni bërë janë dështime dhe jam shumë i zhgënjyer me punën e juaj që nga fushata që keni thënë do të jem kryetar i të gjithë qytetarëve pa dallime partiake. Kam qenë në Komunë dhe kam pritur një muaj ku kam lënë edhe numrin e telefonit për të më lajmëruar dhe të gjitha kërkesat që i kam bërë e kam shkruar numrin e telefonit dhe asnjëherë Komuna nuk na ka informuar kur kanë dal në teren. Kam thirrur pronarin e kompanisë ku i kam treguar që një kanal nuk po na e hap dhe janë do thera 20 metra për ti larguar të cilat janë të ngjitura me kanalën dhe përgjigja e tij ishte që dal nesër të thirri, ka qenë dy herë nuk kemi pasur mundësi të takohemi. Një rrugë 160 metra është shtruar dhe 2 kamionë asfalt janë shtruar. Në ora 21:30 kanë ardhur nga kompania në mbrëmje dhe lopata nuk kishin që ta shpërndajnë asfaltin e as grabuja, është dashtë që banuesit e lagjes ti japin kompanisë pajisjet e veta për shtrimin e asfaltit.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi asfalti është shtruar në rrugën e cekur nga parafolësi dhe ne si autoritet jemi kompetent për të përcjellë punimet aty. Sa për informacion, nuk ka ditë dhe javë që nuk pres qytetarë me dhjetëra dhe qindra. Çdo javë kam takime të rregullta qoftë ditën e enjte apo të premte ku të gjithë janë të thirrur, kështu që po më vjen shumë keq që parafolësi nuk ka pas mundësi për të më takuar, por edhe nëse nuk je ardhur te unë asgjë keq nuk ke mbetur nëse ke shkuar dhe e ke takuar drejtorin, Drejtori është përgjegjës për atë punë, është përgjegjësi e Drejtorit e jo Kryetarit sepse kryetari nuk merret me atë problematikë dhe në këtë rast personi përgjegjës jep përgjegjësi dhe nëse thua se asfalti ka qenë 5 metra dhe është kthyer në 3 metra kjo nuk ka logjikë të bëhet kjo por me këtë çështje do të merrem. Nëse i keni kërkuar drejtorit që të merret me këtë problem dhe nuk është marr atëherë unë do të merrem me të, por mos u merakos sepse asnjë lëndë nuk mbetet pa u trajtuar, për ata dhe jam këtu.

Bahri Kastrati, theksoi, e kam bërë edhe një kërkesë për shtrimin e trotuarit me kubëza deri te lagjja jonë, te trafo këtu lartë, dhe nuk kemi marrë asnjë informatë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, do të merrni edhe informatën, mirëpo dua të theksoj se ti je duke u thirrur në emër të përfaqësuesit të lagjes mirëpo ne nuk kemi ende përfaqësues të lagjes, kështu që shprehu si person, si individ dhe jo në emër të përfaqësuesit së lagjes, ne jemi duke i zgjedhur këshillat e fshatrave dhe ata janë përfaqësues të fshatrave, por megjithatë mirë shumë si qytetarë respekt për këto sugjerime dhe vërejtjet e juaja.

Bahri Kastrati, theksoi, unë nuk e përfaqësoje asnjë parti politike, unë vetëm lagjen time sepse ajo më ka zgjedhë, ku kam qenë në Kërpimëh dhe kanë mbajtur mbledhje për përfaqësues ka dështuar që të zgjidhet kryetari i këtyre lokaliteteve, por përfaqësuesit i kemi zgjedhur dhe i kam të gjitha nënshkrimet e lagjes ku lagja e jonë e ka zgjedhur përfaqësuesin.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ne ende nuk kemi përfaqësues të zgjedhur drejtpërdrejtë në atë pjesë, kur ti kemi personat legjitim atëherë flasim në emër të atij legjitimiteti. Meqenëse nuk është përmbyll procesi nuk mund të llogarisim që kemi përfaqësues, por sidoqoftë ju i paraqitët disa nga vërejtjet dhe kjo është krejt në rregull. Sa i përket trotuarit nuk jam në dijeni se a ka qenë projekt, nëse është planifikuar ai projekt atëherë besojë që do të kryhet, nëse nuk është paraparë atëherë duhet të planifikohet për vitin e ardhshëm.

z. Leturim Krasniqi, Drejtor i DPUMM theksoi, një herë jam takuar me z. Bahri Kastratin dhe po çuditë për këtë lloj kontrasti të diskutimit nga ana e tij. Unë nuk kam pranuar kërkesë konkrete nga ana e tij dhe këto po i dëgjoj për herë të parë. Sa i përket cilësisë dhe formave të tjera tjera të paraqitura unë do të dal në teren për t'i verifikuar, projekti për asfaltimin e rrugës ka qenë për 3 metra dhe jo për 5 metra dhe ashtu si ka qenë kontrata e kemi ekzekutuar projektin.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, nuk e kuptova se a ka pasur asfalt në atë rrugë më herët apo nuk ka pasur.

Bahri Kastrati, theksoi, më herët nuk ka pasur asfalt sepse është mbetur në gjysmë rruga, tash ku është mbetur rruga në gjysmë pa punuar është 5 metra.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, sa shtëpi janë aty ku ka mbetur rruga në gjysmë pa punuar.

Bahri Kastrati, janë tri shtëpia aty.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, nuk bëhet asfalti 5 metra për tri shtëpi, nesër Drejtori punën e parë do të dal në teren për të parë se ku qëndron problemi ndërsa ti e pret aty dhe i jep sqarimet dhe vërejtjet ndërsa ne mandej e konstatojmë nëse ka lëshime në punën dhe projektin e cekur. Nëse ka lëshime unë të garantoj se ajo kompani ka për tu marr sërish me atë punës, por nëse nuk ka lëshime atëherë nuk është mirë të dalësh me lajme të pavërteta.

z. Leturim Krasniqi, Drejtor i DPUMM, theksoi, rruga në fjalë është pjesë e lagjes së Kastratëve e cila ngjitet afër maleve atje, në këtë rast kërkesa ka qenë për asfaltimin e rrugës

dhe është e vërtetë që pjesa e parë e rrugës është 5 metra por ne e kemi vazhduar në bazë të mundësive tona buxhetore me 3 metra, siç tha edhe Kryetari më vjen keq që ke dal në formë të një dizoformimi para qytetarëve dhe para mediave, dhe qasjen që e kam ofruar ndaj teje ka qenë me të vërtetë e hapur dhe ju e dini shumë mirë, ndërsa tash po del komplet kundër. Kjo nuk është në rregull pasi që si autoritet jemi të hapur dhe ofrojmë mundësinë për çdo gjë.

Ramadan Demolli, nga fshati Obrançë, theksoi, sa i përket fshatit tonë na jemi shumë në rregull dhe nuk kemi vërejtje, shkolla është duke u ndërtuar e re, rrugët janë ndërtuar, ndriçimin e kemi në rregull, por unë e kam një kërkesë ndoshta nuk është në rregull me kërkuar nga ana e juaj mirëpo tash gjatë fund vitit këto shpërthimet e fishek zjarreve e kanë një krismë të jashtëzakonshme, tjetër gjë nuk kam për të shtuar dhe ju përgëzoj për punën e bërë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, ke të drejtë plotësisht, unë personalisht vetë dola në shesh dhe vërtetë që ka shpërthime tepër të mëdha të cilat sigurisht mund të kenë edhe pasoja por edhe po krijojnë një shqetësim për qytetarët. Duke parë këtë situatë unë sapo e nënshkrova një urdhëresë që t'i ndalojmë ato dhe të njëjtin po e dërgojmë edhe në Stacionin Policor të Podujevës dhe presim që policia të merret me këtë, por edhe inspektorët komunal gjithsesi.

Fidaim Toverlani, nga Podujeva theksoi, në lagjen time është bërë një kolektor që ka kryer shumë punë ku kemi qenë në telashe që 20 vite, pyetja ime është a ekziston mundësia që për vitin 2024 që edhe pjesa tjetër të përfundohet.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, po jam në dijeni dhe në ngjarje, aty kem pasur telashe sepse banorët e asaj pjese e kanë penguar projektin dhe jemi duke diskutuar që të bëjmë një zgjedhje me qytetarët sepse nuk është problemi te ne, por problemi është që qytetarët po pengojnë kalimin e gypit kurse ne e kemi me domosdoshmëri që të kalojë gypi sepse nuk kemi zgjidhje tjetër. Kolektori vazhdon dhe do të shkoj deri te lokaliteti i fshatit Lupq i Poshtëm në daljen administrative të Komunës së Podujevës. Këtë vit kemi pasur dy probleme i pari ka qenë te ju që e cekët dhe i dyti është në fshatin Lluzhan ku edhe aty i kem disa probleme me një banor, ku diskutuam edhe mendojmë për të vazhduar punën por duhet të ndryshohet traseja për të pasur mundësi për të vazhduar puna sepse janë nganjëherë disa raste që është vështirë me gjete mirëkuptim me banorë edhe pse janë ara nuk është një pengesë por ka raste që ka vështirësi.

Fidaim Toverlani qytetar, theksoi, se deri tash jemi shumë të kënaqur sepse çka është premtuar deri tash është bërë sepse tri projekte që janë premtuar deri tash janë përmbushur të gjitha, pjesa e lumit Llap është rregulluar, është larguar deponia e mbeturinave dhe së fundi kolektori.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, duhet të dini që ne jemi në gjysmë të mandatit dhe të gjithë që kanë menduar që për 2 vjet mund të bëjmë mrekulli e kanë gabim, po mundohemi me tërë kapacitetet që i kemi që të kemi shtrirje dhe në asnjë formë nuk bëjmë ndasi, e kemi thënë dhe jemi duke e mbajtur atë premtim, kam thënë që jam Kryetar për të gjithë qytetarët dhe do të bëjë deri në fund këtë punë dhe nuk jemi duke bërë ndasi dhe nuk mundet askush të argumentoj që është duke u bërë ndonjë një ndasi për shkak të këtij subjekti apo subjektit tjetër sepse fundja janë të gjithë qytetarët e kësaj komune dhe e kemi obligim që të ju përgjigjem pozitivisht të gjithëve brenda mundësive financiare që i kemi. Jo të gjitha punët dhe projektet mund të realizohen për një vite, andaj dua që këto takime t'i mbaj me qytetarë shpresojë që në fillim të muajit shkurt ende data nuk është e caktuar mirëpo do të ju njoftojmë me kohë për takimet që do t'i bëjmë në lokalitetet e juaja dhe do të marr kërkesat drejtpërdrejt nga ju dhe ju të jeni atë që do t'i vlerësoni se cilat janë me prioritet, fjala vjen nëse janë tri kanalizime që duhet të kryhen në gjatësi 1 km, me ditë se cili segment është më i rëndësishëm për tu realizuar dhe cilat mbesin vitin tjetër sepse kemi zgjerime të vendbanimeve çdo vit dhe po rriten kërkesat prandaj nuk mundem me thënë që nuk kemi lëshime sepse kemi lëshime edhe na sepse është normale se ku punohet edhe mund të gabohet

dhe nuk pajtoj që jemi të dështuar sepse janë realizuar një numër i madh i projekteve dhe nuk është mirë që të ekzagjerohen kritikrat.

Habib Kuleta nga Podujeva, theksoi, përshëndetje për të gjithë të pranishmit, rruga “ Isa Kuleta” është punuar mirë dhe me standard megjithatë sot e bëra matjen me hapa dhe vërtetova se 15m² mungojnë asfalt konkretisht te unë. Në të gjitha dokumentet shihet mirë që janë dy hyrje e imja dhe e vëllait, e imja ka mbetur sikur kufi shtetëror tash unë jam jashtë Kosove nuk e di se çka të them tjetër, për këtë arsyeje Kryetar jam edhe këtu dhe dëshiroj që konkretisht të bisedojë me Drejtorin e Urbanizmit.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i nderuar, Drejtori i DPUMM është këtu dhe do të përgjigjet por para se të përgjigjet ky dëshiroj që edhe unë të jap një përgjigje në lidhje me këtë, ne zakonisht jemi duke i shtruar rrugët por para shtëpive hyrjet e shtëpive nuk po them që nuk ka lëshim dhe më keq nëse ndokujt i bëhet dhe ndokujt si bëhet sepse nuk është në rregull, nëse ndokujt afër teje ju ka bërë e ty jo atëherë po mendojë që nuk kanë bërë mirë sepse nuk është dashtë me të nda dhe nëse ka ndodh një gjë e tillë më vjen shumë keq që ka ndodh por unë kam tërheq vërejtjet që të jenë shumë të vëmendshëm që në këto pjesët ku lidhen me individuale që të tejkalohen sepse hyrjet individuale dalin shumë dhe nuk kemi mundësi për ti bërë, ne i ndërtojmë rrugët kryesore dhe shumicën e rasteve hyrjet individuale vet e paguajnë kompaninë individët. Ndoshta Drejtori e din këtë punë më saktë po zakonisht nuk praktikojmë ti asfaltojmë hyrjet individuale.

Hakif Mehmeti nga Podujeva rr. “ Xhorxh Bush” , theksoi kemi një problem me ujësjellësin, ujë kemi por aty u bë një intervenim dhe ka mbetur gropa hapur që nga muaji prill dhe është gropë e gjatë përmbi dy metra, pra është shumë e madhe dhe e kemi përball dyerve të shtëpisë.

z. Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës, theksoi, i nderuar këto punët e Ujësllësit nuk janë punë tonat, KUR “ Prishtina’ bënë menaxhimin e tyre dhe është kompetencë e tyre por punën do duhej kryer dhe të mbyllin atë gropë. Nuk nuk janë në menaxhim tonin as ujësjellësi e as njësia e pastrimit, janë kompani regjionale që nuk na japin përgjegjësi neve kështu që unë do të merrna seriozisht me këtë problem dhe do ti jap detyrë Drejtorit të Shërbimeve Publike që të del të merret menjëherë me këtë, sepse është evidente se ka neglizhenca nga ana e tyre.

Kryetari e përmbylli takimin duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin.

Mbledhja përfundoi në orën 15:15

Procesverbalin e mbajti
Sabedin Namani

Nr.Prot.02-060/04-0089963/23
Podujevë, datë:26.12.2023

Kryetar i Komunës
Shpejtim Bulliqi

